

## INHERITANCE BY TESTAMENT

Shpresa Ibrahimimi\* and Fortesa Beqiraj\*\*

### Abstract

Contemporary globalization imposes a new rule on people, which on the other hand motivates them to plan the future from visionary perspective. Furthermore, the visionary perspective from the inheritance law view point, means that the person who bequests his/her heritage plans to share his/her property, among the inheritors whom he/she most trusts and believes that will best fulfill his objectives, and enables the wills of his orders to be achieved even after his/her death.

Inheritance by Testament is part of the group of the “declarations by will” that will have effect even after death. The Institute for the right to inherit arises when we start to think rationally that the material values serve to the community and should not be buried together with the death of physical subject, but to be subject to inheritors. Inheritance by Testament enjoys legal protection in the Law on Inheritance of Kosova, but its application is still not satisfactory, thanks to many factors, which will be the subject of our research paper.

**Keywords:** Property, Right of Succession, Heritage fundamentals requirements, Testament, Notary.

### BAZAT E THIRRJES NË TRASHËGIM

Rregullimi i marrdhënjëve trashëgimore, paraqet një prej kërkesave të qytetarëve, në mënyr që fati i pasurisë trashëgimore të kalojë, në baza të rregullta ligjore, prej trashëgimlënësve në trashëgimtarë. Trashëgimia paraqet kalimin e të drejtave dhe detyrimeve jo personale nga trashëgimlënësi në trashëgimtarë, në momentin e shuarjes së subjektivitetit të tij.

Bazat e thirrjes në trashëgim i gjejmë qysh në Romën e lashtë. E drejta romake rregullonte kalimin e trashëgimlënësit në trashëgimtarë. Testamenti gjenë trajtim të mirëfilltë që nga përpilimi i shkathë i juristëve të drejtës romake.

Kur flasim për bazën juridike, kuptojmë arsyen se ku e gjejmë të drejtën trashëgimtarët në kërkimin e masës trashëgimore. Kosova dhe në përgjithsi e drejta shqiptare ka njohur dhe rregulluar bazat e thirrjes në trashëgim, që nga Kanunet, Kodi Civil i Ahmet Zogut, Kodet Civile të mëvonshme. Edhe Kosova, fillimisht si ish pjesë e krahinës ish jugosllave, ka pas rregullativë për kalimin e trashëgimisë, edhe pse gjithmonë shqipëtarët e Kosovës kanë qenë pre e

---

\*Ph.D. Cand. Shpresa Ibrahimimi- Universiteti ILIRIA, Prishtinë, Republika e Kosovës; Adresa “Fadil Delići ” Nr. 66/ MITROVICË

E-mail: shpresa\_mitro@hotmail.com; Phone: +377 44 671 647

\*\*Msc Fortesa Beqiraj- Universiteti ILIRIA, Prishtinë, Republika e Kosovës; E-mail: [fortesa.beqiraj@uiliria.org](mailto:fortesa.beqiraj@uiliria.org); Phone: +377 44 468 223

diskriminimeve dhe të marrjes së drejtës në trashëgimë. Femrat po ashtu edhe pse kanë qenë të barabarta në aspekt të drejtës së trashëgimit ato nuk kanë pasur të drejtë të trashëgojnë, këtë fal shoqërisë patrialkale që ka ekzistuar në atë periudhë. Pas vitit 1999, sistemi juridik, politik, ekonomik i nënshtohet një transformimi rrënjësor, i quajtur shtetë në tranzicion, si çdo fazë tranzitore, kërkon realizimin imperativ të rregullimit ligjor të gjitha sferave, edhe atë të drejtës së trashëgimisë.

Ligji për trashëgiminë e Kosovës, paraqet ligjin e aplikueshëm për rregullimin e marrdhënjeve trashëgimore, ligj që për nga përmbajtja është në pajtim me standartet ndërkombëtare, europiane dhe në pajtim me Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ligji për trashëgiminë e Kosovës,<sup>1</sup> përcakton se: Neni 1.1.Me këtë ligj rregullohet e drejta e trashëgimisë.

Bazë e thirrjes në trashëgim sipas Ligjit për Trashëgimin e Kosovës paraqitet: Neni 1.2. Trashëgimia është kalimi me ligj ose në bazë të testamentit i pasurisë (trashëgimit) së personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek një ose më shumë persona (trashëgimtarët ose legatarët), sipas rregullave të caktuara në këtë ligj. Siç edhe mund të interpretohet se konkurojnë bazat për thirrje në trashëgim. Bazë e primare për thirrje, posedon testamenti,<sup>2</sup> është e natyrshme, sepse personi fizik, gjatë gjithë jetes mundohet të krijoj, të ruaj dhe në fund të ndaj këto vlera me të tjerët, që aje konsideron se janë më të denjët për të realizuar vizionin e tij. Në këtë mënyrë neni i LTK- së: Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm. Këtë mënyrë të konkurimit të bazave në trashëgimi e gjejmë në gjitha kodet civile dhe Ligjet e trashëgimore moderne.

Rregullimi i marrdhënjeve trashëgimore, në ligjin tonë, i përshkrijnë parimet bazë për aplikimin e drejtë dhe të paanshëm të normave në rastin konkret trashëgimorë. Rregullimi në këtë mënyrë duke respektuar parimet bazë, i bënë që qytetarët e Kosovës pa dallim gjinije, feje, etnike, kulture, janë të barabartë para ligjit për trashëgiminë. Po që se shihet në retrospektivë, shohim që qytetarët shqiptarë ishin të diskriminuar për t`u thirrur në bazat e trashëgimisë. E femrat, si krijesa fizike ashtu edhe si gjinia mashkullore, për shoqërinë shqiptare kanë pas fatin më të keq të mundshëm. Nëse e rishikojmë dispozitën e Kanunit të Lek Dukagjinit se femrat nuk trashëgojnë as te prindi e as te burri, në lënë të kupojmë se sa ato kanë pas mundësinë të jenë të barabarta në realizimin e të drejtës në trashëgimi. Ligji i Kosovës për trashëgimi njëhë dhe garanton barabartësinë e gjinisë femrore dhe mashkullore për të trashëguar vlerat e paraardhësit. Por edhe të bashkëshortesë si trashëgimtarja e parë ligjore, që së bashku me fëmijët trashëgon në mënyrë të barabartë.

Përveç kësaj barazie, fati i fëmijëve të pa kurorë, jashtëmartesorë për një kohë të gjatë ishin të diskriminuar, në të vërtetë për t`a përdoren edhe emra ofendues `` kopil `` Fatmirësisht pozita e bashkëshortesë jashtëmartesore dhe fëmijëve jashtëmartesorë, barazohet dhe ata kanë të drejtë

<sup>1</sup> Ligji Nr. 2004 / 26- Ligji për Trashëgiminë e Kosovës

<sup>2</sup> Podvorica, Dr Hamdi, E drejta Trashëgimore; Prishtinë 2008, fq 23

trashëgimi sikur bashkëshortja legjitimi, fëmijët legjitim dhe të adoptuarit. Neni 3. Të gjithë personat fizikë në kushte të njejta janë të barabartë në trashëgimi. Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar

me vendim të gjykatës apo të organit kompetent si dhe fëmijët e adoptuar barazohen me fëmijët legjitim. I adoptuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë.

Parim tjetër i rëndësishëm për mbrendin dhe aplikimin e ligjit të trashëgimisë paraqitet edhe titullit të trashëgimitarit univerzal dhe singular. Paraqitja e dy titullarëve të ndryshëm për të fituar të drejtën në trashëgimi, paraqitet se; njëri trashëgimtarë, trashëgonë gjithë masën pasurore, apo pjesë të veçantë të saj, por fitimin e kësaj pjese të pasurisë trashëgimore, i korespondon detyrimi për përgjigjet në borgjet e trashëgimisë.<sup>3</sup> Këta trashëgimtarë univerzal, përbëjnë grupin e trashëgimtarëve ligjorë, që ligji ynë, njehë: katër rradhë trashëgimore. Trashëgimtari singular, paraqitet vetëm si fitues i titullit të vetëm, individual, si e drejtë kërkese, e drejtuar në rradhë të parë trashëgimtarëve univerzal për realizimin e kërkesës së tyre, të përcaktuar nga trashëgimtari si urdhër dhurimi në favor të legatarve.<sup>4</sup>

Realizimi i përfitimi në trashëgimi, nga trashëgimtarët, që në momentin e vdekjes së trashëgimlënsit, është një prej risive që e heq rregullin e vjetër të trashëgimisë së fjetur,<sup>5</sup>

sepse, trashëgimia hapet që në momentin e vdekjes së trashëgimlënsit dhe kalon në trashëgimtarë, pa pasur nevojën e pranimit, por ata nuk posedojnë detyrimin e pranimit të trashëgimisë, ata mund të heqin dorë edhe prej saj, çoftë në emer të tyre, apo edhe të trashëgimtarëve të tyre.<sup>6</sup> Në këtë mënyr e përcakton edhe Neni 4.<sup>7</sup> Trashëgohet për shkak të vdekjes dhe në momentin e vdekjes së personit fizik. Vetë titulli i trashëgimisë është titull bujarie, mëshire, dhurimi, pasi që nuk paraqet obligime më të mëdha të trashëgimtarëve se sa që trashëgojnë. Në këtë mënyr trashëgimtarët trashëgojnë, vlera pasurore, kushte afate, për të cilat përgjigjen deri në vlerën sa trashëgojnë, nuk përgjigjen për tejkalimet që paraqiten nga masa trashëgimore.<sup>8</sup> Bazën ligjore e gjejmë në Nenin të LTK- së: Neni 5.3.E drejta në trashëgimi fitohet në momentin e vdekjes së trashëgimlënsit. Fituesi i të drejtës në trashëgimi mund të heqë dorë nga kjo e drejtë sipas dispozitave të këtij ligji, me ç'rast do të merret se këtë të drejtë asnjëherë nuk e ka fituar.

## TESTAMENTI NË LIGJIN MBI TRASHËGIMINË E KOSOVËS

Bazë primare, për të kaluar vlerat pasurore, prej trashëgimlënsit në trashëgimtarë, është testamenti. Testamenti paraqet dëshirën e fundit të trashëgimlënsit me anë të të cilit përcakton trashëgimtarët, masën pasurore që i`u kalon dhe kushtet, barrët që mund të lërë. Në këtë mënyr e

<sup>3</sup> Dhima, Ken, E drejta Romake, Tiranë, 2007, fq 778

<sup>4</sup> Ibrahim, Shpresa; `` Institut of legacy in the testament``, Ilira International Rewiev; [Issue 2011/1](#)

<sup>5</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashëgimore; Prishtinë, 2006; fq 22

<sup>6</sup> Latifi, Juliana, Enver Buçaj; E drejta e Trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë, 2009; fq 43

<sup>7</sup> Ligji Nr. 2004 / 26- Ligji për Trashëgiminë e Kosovës

<sup>8</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashëgimore; Prishtinë, 2006; fq 105

përcatkon Neni 69 i LTK- së: Testament do të thotë shprehje e vullnetit të fundit e dhënë në formën e paraparë me ligj, me të cilin trashigimlënësi (testatori) urdhëron si të veprohet me pasurinë e tij pas vdekjes së tij.

Edhe shqiptarët në përgjithsi, por edhe Kosovarët në veçanti, testamenti ishte i njohur dhe i rregulluar me anë të rregullave të aplikueshme, në kohën që përkonin. Duke u bazuar në të drejtën romake, Statuset e Shkodres, njihnin testamentit si bazë juridike për trashëgim, ndërkaq kanuni i Lekë Dukagjinit, nuk njeh si fitim të drejtës në trashëgimmi testamentin, por vetëm të lanunat në favor të kishtes.<sup>9</sup> Por sa në realitet është aplikur?!, mund të themi që aplikimin në kuptimin e mirëfilltë të saj e gjejm në shekullin e XX- të. Arsyeya ndoshta se qëndron, jo pse nuk gjente aplikim por, ajo konstituohej në formë të `` amanetit. `` gjithmonë trashëgonin djemtë e familjes, gjinia femrore vinte rrallë në shprehje për të fituar të drejtë trashëgimi.

Shturja e bashkësive të mëdha, lindja e familjeve me numër të vogël të antarëve,<sup>10</sup> nevoja për planifikim të jetës dhe të pasurisë, për periudhë më të gjatë kohore, është e domosdoshme, dhe ka filluar të aplikohet përpilimi i testamentit. Bazë juridike janë kushtet e përcaktuara imperative për të përpiluar testament të vlefshëm.

Në ligjin për trashëgimin e Kosovës, përcaktohen kushtet për të qenë një testament i vlefshëm, në rradhë të parë kërkohet zotësia testamentare e personve fizik, e që është mosha 18 vjeçarë, përkatsishtë 16 për personat e emancipuar. Nëse testamentuesi, nuk posedon zotësi testamentare, nuk është i aftë mendërishtë, sjellë pavlefshmërinë e testamentit. Neni 71 dhe 80 i LTK- së: Testament mund të bëjë çdo person që ka zotësi për të vepruar dhe i cili i ka mbushur 18 vjet. Testamentit është i pavlefshëm nëse është bërë me kanosje, shtrëngim ose mashtrim. Për dallim, në Kodin Civil të Rrepublicës së Shqipërisë,<sup>11</sup> mosha e testamentuesit për të përpiluar testament është nga 14 gjer në 18 vjeç vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij.

## **PËRMBAJTJA E TESTAMENTIT**

Gjatë përpilimit të testamentit, trashëgimlënësi posedon liri në përcaktimin e dispozitave të tij. Liria e testamentshkresit, gjindet në dispozitat e Ligjit për trashëgiminë e Kosovës. Edhe pse testamenti paraqet akt bujar, ligji ndërhyt me anë të normave imperative, se trashëgimlënësi, nuk mund të cenoj pjesën e domosdoshme.<sup>12</sup> Neni 31 i LTK- së: Trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurinë trashëgimore me të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponojë dhe e cila quhet pjesë e domosdoshme.

---

<sup>9</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shtefan Gjeqovi, Shkoder, 1933, Nye tridhjetetë

<sup>10</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E Familjare; Prishtinë, 2006; fq 34

<sup>11</sup> Kodi Civil i Rrepublicës së Shqipërisë me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjin nr.8536, datë 18.10.1999 ligjin nr.8781, datë 3.5.2001 dhe ligjin nr.17/2012

<sup>12</sup> Galogano, Francesko, E drejta Private; Tiranë, 2006; fq 994

Pasi që testamenti, paraqet dëshirën e fundit të trashëgimlënsit, dëshirë që vet e shkruan, daton e nënshkruan, na lënë të kuptojmë se dispozitat e testamentit, janë të natyrës pasurore në rradhë të parë, pastaj dispozitë të natyrës personale, që shprehën në urdhëra, qëllime, barrë, njohje të fëmijës si të vetin,<sup>13</sup> pastaj dispozitë të quajtura kushtimishtë teknike, siç është caktimi i ekzekutuesit të testamentit.<sup>14</sup>

Qëllimi parësor i testamentit paraqitet caktimi i trashëgimtarëve, që konsideron të denjë për të fituar vlerat e trashëgimlënsit. Testamentuesi përcakton në mënyrë të lirë trashëgimtarët testamentar, bile edhe zëvendësuesit testamentar, pasi që tek testamenti nuk zabtohet e drejta e përfaqësimit, por vetëm e drejta e shtimit.<sup>15</sup> Por edhe pse gëzon liri në përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve, i kufizohet e drejta e cenimit të drejtës në trashëgimi të trashëgimtarëve ligjorë, e që sipas LTK-së janë katër rradhë trashëgimore. Në Kodin Civil të Rrepublicës së Shqipërisë, paraqitet si kufizim deri në rradhën e tretë trashëgimore.

Trashëgimtarë, mund të paraqiten personat fizik dhe institucionet publike<sup>16</sup> me kushtë që të jenë gjallë dhe të denjë për të trashëguar në kohën e hapjes së testamentit. Neni 7.1. i LTK-së Personi që në kohën e hapjes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënsit dhe ka lindur i gjallë, ka zotësi për të trashëguar. Konsiderohet se ka qenë zënë në kohën e hapjes së trashëgimisë, ai person që ka lindur i gjallë brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënsit.

Qëllimi i caktimit të trashëgimtarëve testamentar, është që ata të fitojnë e gjithë trashëgiminë apo pjesë të caktuara nga pasuria trashëgimore. Përcatimi në këtë formë i fitimit të pasurisë trashëgimore na lë të kuptojmë se kemi të bëjmë me trashëgimtarin univerzal, pra trashëgimtarin e gjithë apo një pjesë të caktuar trashëgimore, por jo vetëm të drejtave por e edhe detyrimeve që rrjedhin nga ky fitim. Neni 119.2. i LTK-së përcakton obligimet e trashëgimtarëve që rëndojnë barrën trashëgimore: Borxhet që ngarkojnë trashëgiminë janë: barrët mbi trashëgiminë, borxhet personale të trashëgimlënsit, shpenzimet e varrimit, shpenzimet e nevojshme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë deri në momentin e ndarjes së trashëgimisë. Por qëllimi i dispozitës së njëanshme, me efekt pas vdekjes, testamentit është dhurimi, e jo obligimi i përmbushjes më tepër se sa fiton, se trashëgimtari përgjigjet për borxhet e trashëgimlënsit, deri në vlerën sa fiton, tejkalimi i kësaj vlere nuk e obligon trashëgimtarin për përmbushje. Neni 119.1. i LTK-së: Trashëgimtarët janë përgjegjës për borxhet që ngarkojnë trashëgiminë në proporcion me pjesën e tyre dhe deri në vlerën e tyre të pjesës trashëgimore.

Një tjetër titull fitimi në pasurinë trashëgimore, paraqitet suksesioni singular,<sup>17</sup> apo fitimi i vetëm një të drejte kërkesë nga trashëgimlënsi, drejtuar personave të urdhëruar për përmbushje. Emërimi i suksesorit singular, quhet legatar. Legatari paraqet vetëm fitues i një titulli individual,

<sup>13</sup> Ligji NR. 2004/32; Ligji mbi Familjen i Kosovës Neni 103. 3 Atësia gjithashtu mund të njihet edhe me testament.

<sup>14</sup> Latifi, Juliana, Enver Buçaj; E drejta e Trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë, 2009; fq 95

<sup>15</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashëgimore; Prishtinë, 2006; fq 104

<sup>16</sup> Neni 88.3. i LTK-së: Kur testatori ia lë me testament pasurinë organeve publike, ose institucioneve të tjera, ai mund të caktojë në testament qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria.

<sup>17</sup> Ibrahim, Shpresa; `` Institut of legacy in the testament``, Ilira International Rewiev; [Issue 2011/1](#)

i cili nuk përgjigjet për borgjet e trashëgimlënsit.<sup>18</sup> Neni 93.1. i LTK-së i përcakton në këtë formë leget: Testatori mund të lërë me testament një ose më shumë sende të caktuara ose ndonjë të drejtë personit të caktuar, të urdhërojë trashëgimtarin ose ndonjë person tjetër, të cilit i lë diçka që nga ajo që i është lënë të japë ndonjë send një personi të caktuar, t'i paguajë një shumë të hollash, ta lirojë nga ndonjë borxh e ta mbajë ose në përgjithësi të bëjë diçka, të përmbahet nga ndonjë veprim ose të fitojë diçka në dobi të tij. Për dallim prej suksesorit univerzal, trashëgimtari singular, ka përparsi në realizimin të legut, nuk përgjigjet për borgjet e trashëgimlënsit, dhe deri sa raporti mes testamentuesit dhe trashëgimtarit univerzal, paraqet raport direkt, sepse që në momentin e vdekjes së trashëgimlënsit, trashëgimtari fiton të drejtën në trashëgim.<sup>19</sup> Trashëgimtari legatar, nuk krijon raport të drejtëpërdrejtë me trashëgimlënsin, por prej momentit të vdekjes së trashëgimlënsit, fiton një të drejtë kërkese drejtuar titullarëve për realizimin e legut, përmbushjen e urdhërit të vullnetit të trashëgimlënsit.

Trashëgimlënsi trashëgimtarëve, legatarëve mund të ju përcaktoj edhe barrë, kushte e afate.<sup>20</sup> Qëllimi i përpilimit të testamenteve,<sup>21</sup> qëndron pikrishtë në dëshirën e trashëgimlënsit që të jetë më vizionarë për fatin e pasurisë së tij, duke për caktuar edhe se në çfarë destinimi mund të shkoj masa pasurore e tij, që këtë mundësi nuk e ka nëse nuk përpilon testamentë.<sup>22</sup>

Nëse e analizojmë qëllimin e përpilimit të testamenteve, në të kaluarën, vërjëm ndikimin e kultit fetarë, duke i obliguar trashëgimtarët në martesë mes pjestarëve të një feje, apo duke i imponu martesë me persona të caktuara. Imponimi në lirinë e zgjedhjes së personit për të lidhur martesë, për Ligjin për familjen e Kosovës, e bënë të pavlefshëm, sepse mosha madhore i mundëson personit fizik të zgjedhë personin pa asnjë ndërhyrje të tjerëve për lidhjen e martesës. Edhe LTK-së specifikon se nuk guxon të imponohet trashëgimtari në përmbushjen e barrëve, kushteve dhe afateve të pamundshme, të palejueshme. Përcatimi i këtyre barrëve, kushteve dhe afateve të palejueshme, jo morale, të pamundshme, e bënë disponimin testamentarë të pavlefshëm. Neni 89.3. i LTK- së: Kushtet dhe barrët e pamundshme, të palejuara dhe jomorale, si dhe ato që janë të pakuptueshme ose kontradiktore, konsiderohen sikur nuk ekzistojnë.

Përveq trashëgimtarëve, legatarëve, barrëve, kushteve e afateve që fitojnë nga trashëgimia, një testament mund të përmban edhe caktimin e ekzekutuesve të testamentit. Ekzekutesit e testamentit mund të jenë trashëgimtarët ligjor, por mund të jetë edhe çdo person tjetër që e përcakton trashëgimlënsi, me kusht që të ketë zotësi testamentare. Ekzekutuesit, kanë si detyrim të përmbushin detyrimet që nga invertaizimi i masës pasurore, pagimi i borgjeve të

---

<sup>18</sup> Puhan, Ivo, E drejta Romake, Prishtinë 1968, fq 384

<sup>19</sup> Biçoku, Nazmi, E drejta e Trashëgimisë e RRPSSH- së, Tiranë, 107

<sup>20</sup> Ibrahim, Shpresa; `` Institut of legacy in the testament``, Ilira International Rewiev; [Issue 2011/1](#)

<sup>21</sup> Neni 88.1. i LTK- së: Testatori mund të urdhërojë me testament që një send ose e drejtë ose një pjesë e pasurisë trashëgimore ose tërë pasuria trashëgimore të përdoret për të arritur një qëllim të lejuar.

<sup>22</sup> Neni 89.1. i LTK- së: Testatori mund të ngarkojë me ndonjë detyrim personin të cilit i lë ndonjë përfitim nga pasuria trashëgimore. Dispozitat testamentare mund të bëhen me kushte ose afate.

trashëgimlënësit, ekzekutimi i legeve, kushteve, barrëve dhe afateve. Ashtu si në gjitha ligjet dhe Kodet Civile edhe në LTK- ën detyrat e ekzekuesit caktohen ekzekutuesi i testamentit ka sidomos për detyrë të kujdeset për ruajtjen e pasurisë trashëgimore, ta drejtojë atë, të kujdeset për pagimin e borxheve dhe legeve, dhe në përgjithësi të kujdeset që testamenti të ekzekutohet ashtu si ka dashur testatori.<sup>23</sup> Deri sa në ligjin për trashëgiminë e Kosovës, caktimi i ekzekuesit të testamentit, nëse nuk është caktuar, apo është shkarkuar për refuzim apo keqpërdorim të përmbushjes së detyrimeve, zëvendësin e cakton Gjykata trashëgimore, me nxerrjen e Ligjit mbi Noterin e Kosovës, kompetencat që nga përpilimi, kujdesja për ekzekutim dhe ruajta e testamentit, bien mbi shërbimin publik të noterisë. Neni 29. pika 1. 3 i LNK- ën,<sup>24</sup> trajtimi i të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore. Edhe në Rrepublicën e Shqipërisë çështjet trashëgimore, bien në kompetencë të shërbimit të Noterisë.<sup>25</sup>

## **REVOKIMI DHE PAVLEFSHMËRIA E TESTAMENTIT**

Përveq një mori benefiteshë që sjellë përpilimi i testamentit, një prej tyre shumë i pëlqyeshëm për testamentshkruerin është edhe mundësia e revokimit të tij, në çdo moment kur ajë e konsideron të arsyëshëm. P.sh për momentin aktual mund të konsiderohet i denjë një titullarë për të trashëguar vlerat pasurore trashëgimore, por më vonë të ndrojë sjellje dhe qëndrim, çka i mundëson testamentshruesit të revokoj testamentin, qoftë në tërsi, apo pjesë të caktuar të saj.

Revokimi i testamentit mund të jetë në tërsi apo pjesë të caktuar të saj. Revokimi po ashtu mund të jetë revokim shprehimishtë apo i heshtur.<sup>26</sup> Testamenti është akt rigorzë personal, nuk lejohet asnjë ndërhyrje në dëshirën e tij, e edhe revokimi është nga aktet rigorzishhtë personal që si të tillë mund të bëjë vetëm testamentshkrueri edhe deklarata për ndryshimin e testamentit duhet të bëhet në formën që është përpiluar testamenti.<sup>27</sup> Forma e revokimit të testamentit për të drejtën franceze nuk paraqitet e rëndësishme, pasi sipas tyre një testament autentik, mund të revokohet me testament alograf.<sup>28</sup> Edhe në të drejtën trashëgimore Greke e Turke, forma duhet plotësuar që të krijoj efekt deklarata e revokimit të testamentit. Deklarata për revokimin e testamentit, duhet dhënë në mënyr që të mos lë dyshime edhe për pjesën që heq dorë, sepse nëse ka paqartësi për gjerësin e heqjes dorë nga trashëgimia, atëher testamenti i mëparshëm mbetë në fuqi, nëse nuk është në kundërshtim me testamentin e mëvonshëm.<sup>29</sup> Nuk është e parëndësishme, përcaktimi edhe i datës, shkrimit dhe nënshkrimit nga trashëgimlënësi, sepse nëse vjen një testament i ri, me

---

<sup>23</sup> Neni 103 i LTK- së

<sup>24</sup> Ligji nr 03/L-010 për Noterinë

<sup>25</sup> Osman Dedja, Noterët, ja si do të lëshohet dëshmia e trashëgimisë; 04. 04. 2013. Gazeta Republika, Shqipëri, Tiranë 2013

<sup>26</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashëgimore; Prishtinë, 2006; fq 108

<sup>27</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashëgimore; Prishtinë, 2006; fq 109

<sup>28</sup> Latifi, Juliana, Trashëgimia me Testament ( vështrim krahasues ); Tiranë, 1999; fq 46

<sup>29</sup> Neni 108 i LTK- së 108.1: Në qoftë se me testamentin e mëvonshëm nuk revokohet shprehimishtë testamenti i mëparshëm dispozitat e testamentit të mëparshëm mbeten në fuqi, po qe se nuk janë në kundërshtim me dispozitat e testamentit të mëvonshëm.

shkrimin dhe nënshkrimin e testatorit, testamenti me afat të ri, e bënë të pavlefshëm testamentin e më hershëm.<sup>30</sup> Një testament mund të jetë edhe pjesërishtë i pavlefshëm, nëse testatori me testamentin e ri, një pjesë të sendeve apo vlerave pasurore i tjetëron tek një titullar tjetër, e bënë pjesërishtë të pavlefshëm, testamentin. Neni 109 i LTK- së: Çdo disponim i mëvonshëm nga ana e testatorit të sendit të caktuar që ia ka lënë dikujt me testament ka si pasojë revokimin e lënies me testament të këtij sendi. Revokimi në heshje i testamentit, paraqitet në situatat kur testatori, e kërkon shprehimishtë në dispozitat e testamentit të mëvonshëm, kur ka kundërshtime mes dispozitave të testamentit të mëparshëm dhe më vonshëm janë në kundërshtim me njëri tjetrin<sup>31</sup> dhe nëse trashëgimlënësi ka asgjësuar testamentin e mëvonshëm.<sup>32</sup> Pasi që çështjet trashëgimore, përkatsishtë testamentare, hynë në fushveprimtarinë e noterëve, testatori mund të jap deklaratën e revokimit të testamentit para noterit, deklarata e dhënë regjistrohet, dhe shërben si revokim i plotëfuqishëm i testamentit të më parshëm.

Qëllimi i përpilimit të testamentit qëndron në vlefshëmrinë e dispozitave të tij, që të krijojnë efekt, pas vdekjes së trashëgimlënësit. Pasi që testamenti është aktë i njëanshëm, rigorizishtë personal, akt formal, janë të përcaktuara dispozitat e përpilimit të testamentit të vlefshëm, duke hequr munësin e çfardo ndërhyrje në vullnetin e testatorit. Sepse ndërhyrja në vullnetin e testatorit, qoftë e shprehur si dhunë, kanosje, lajthim e mashtrim, testamentin e bënë absolutishtë nule.<sup>33</sup> Po ashtu zotësia e veprimit duhet të ekzistoj gjatë përpilimit të testamentit, mungesa e zotësisë po ashtu e bënë testamentin e pavlefshëm. Forma është e rëndësishme, pasi që përpilimi i testamentit është akt rigorizishtë personal, mungesa e formës e bënë testamentin absolutishtë të pavlefshëm. Për vlefshëmërinë e formës kuptohet, kërkohet, shkrimi i testamentit nga dora e trashëgimlënësit, datimi dhe nënshkrimi i tij nga testatori.<sup>34</sup>

Pjesa e domosdoshme e pasurisë trashëgimore, po ashtu paraqet kuotë që normat imperative trashëgimore, përcaktojnë se nuk guxon të cenohet, sepse cenimi kësaj pjesë e tejkalon bujarinë e trashëgimlënësit, dhe i cenon interesat e trashëgimtarëve ligjorë, që janë fmijët, bashkrortija, prindërit e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre, si rezultat e bënë disponimin testamentarë të pavlefshëm dhe detyrimin e kthimit të kësaj vlere trashëgimtarit ligjor. Neni 38.2. i LTK-së: Pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën disponibile. Kjo vlerë përfshin dhurime dhe disponime me testament për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit të domosdoshëm në pjesën trashëgimore të tij.

---

<sup>30</sup> Latifi, Juliana, Enver Buçaj; E dreta e Trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë, 2009; fq 85

<sup>31</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashegimiore; Prishtinë, 2006; fq 109

<sup>32</sup> Neni 108.2 i LTK-së: Në qoftë se trashëgimlënësi ka asgjësuar testamentin e mëvonshëm, testamenti i mëparshëm mbetet në fuqi.

<sup>33</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashegimiore; Prishtinë, 2006; fq 115

<sup>34</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashegimiore; Prishtinë, 2006; fq 113



Edhe vdekja e trashëgimtarit të caktuar në testament, para trashëgimlënësit e bënë të pavlefshme dispozitën në favor të tij dhe pjesa e tij trashëgimore i kalon subsituesit të tij, po që se e ka caktuar testatori, në të kundërtën i kalon trashëgimtarit ligjor.<sup>35</sup>

## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

- Testamenti për të drejtën shqipëtare paraqet institut të njohur dhe të trajtuar që nga statutet e Shkodres, Kanunet, megjithëse jo ndoshta me të njejtin emërtim. Bazuar në këtë, Kosova po ashtu ka pasur dhe ka bazë ligjore, Ligjin për Trashëgimin e Kosovës për të përpiluar dispozitën e testamentit.
- Ligji mbi Trashëgiminë, është në harmoni edhe me rregullat e BE- së për çështjet testamentare, paraqet ligj që për herë të parë, qytetarëve të Kosovës ju siguron, garanton barabartësi në çështjet trashëgimore. Barabartësi të gjinisë femrore dhe mashkullore, barazi të fëmijve martesor dhe jashtëmartesor, të adoptuarve. Barazi që më herët nuk e kanë gëzuar, femrat dhe fëmijët jashtëmartesorë. Por relikti i mentalitetit të disa trevave, megjithëse për momentin është zbutur, femrat nuk gëzojnë në realitet të drejtë trashëgimore. Rekomandimi qëndron në vetëdijimin e femrave për të drejtë trashëgimore, në mënyr të barabartë, përgjegjisi që konsideroj edhe të noterit, tani më kompetent për qëshjet trashëgimore se në rast të përpilimit të testamentit, tërheqjen e vërejtjes, për dispozitat e pjesës së domosdoshme.
- Deri tani nuk ka qenë praktikë lënja e testamenteve, ndoshta për faktorë të ndryshëm, ndoshta një pjesë të fajit mund të i` a lëjmë procedurat e gjata gjyqësore, sa që individët edhe kanë hequr dorë nga përpilimi i testamentit. Por tani më e institutjionalizimit të shërbimit të noterisë në Kosovë, dhe tani më nga shtatori bartjen e kompetencave të gjykatave për çështjet testamentare dhe trashëgimore te noteri në Shqipëri, besoj që qytetarët kanë për të filluar përpilimin e testamentit, si aktë rigorozë personal, që i bënë ata më të sigurtë, se vlerat e fituara me mund, kalojnë tek personat që ata konsiderojnë që janë më të denjë për të realizuar vizionin e tyre.

## **LITERATURA**

Andrew Borkowski dhe Paul Du Plessis, ``E Drejta Romake I`` , Tiranë, 2004

Biçoku, Nazmi, E drejta e Trashëgimisë e RRPSSH- së, Tiranë, 1984

Galogano, Francesco, E drejta Private; Tiranë, 2006

Ibrahimi, Shpresa; `` Institut of legacy in the testament`` , Ilira International Rewiev; [Issue 2011/1](#)

---

<sup>35</sup> Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashegimiore; Prishtinë, 2006; fq 55

Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shtefan Gjeqovi, Shkoder, 1933

KODI CIVIL I RREPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjin nr.8536, datë 18.10.1999 ligjin nr.8781, datë 3.5.2001 dhe ligjin nr.17/2012

Ken Dhima, `` E drejta Romake `` , Tiranë, 2007

Ligji mbi Trashëgiminë e Kosovës, Ligji Nr. 2004 / 26

Ligji nr 03/L-010 për Noterinë

Ligji NR. 2004/32; Ligji mbi Familjen i Kosovës

Osman Dedja, Noterët, ja si do të lëshohet dëshmia e trashëgimisë; 04. 04. 2013. Gazeta Republika, Shqipëri, Tiranë 2013

Podvorica, Dr Hamdi; E drejta Trashegimiore; Prishtinë, 2006

Podvorica, Dr Hamdi; E Familjare; Prishtinë, 2006;

Puhan, Ivo, E drejta Romake, Prishitnë 196